

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.19.01.2021*

19.01.2021

Ora 17:00

**RENDI I DITËS**

**Projektakti “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe sensibilizimit të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ:**
- **Illirjan CELIBASHI** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ** Y.Merkaj, Ermina Allushi,  
Madalena Koja
- **Parti politike** Z.Altin Kaziaj (LSI)

**Z.I.Celibashi:** Mirë atëherë mund të fillojmë. Faleminderit z.Kaziaj për prezencën tuaj në këtë mbledhje, në këtë seancë publike e cila ka në objekt, në rend të ditës shqyrtimin e projektvendimit që ka të bëjë me miratimin e programit të edukimit, të zgjedhësve për zgjedhjet e vitit 2021, faleminderit edhe njëherë që e keni vlerësuar këtë akt me prezencën tuaj. Po ja jap fjalën shkurtimisht Sekretarit të KQZ-së për të relatuar shkurtimisht aktin dhe pastaj nëse keni ndonjë kontribut jeni të mirëpritur. Faleminderit!

**Z.Y.Merkaj:** Bazuar në nenin 19 të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kujdeset për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve si dhe nga administrata e KQZ-së, ka përfunduar programi i cili përcakton aktivitetin dhe masat që përdoren në fushatën e informimit të zgjedhësve. Programi është detajuar në 22 faqe dhe është i ndarë në 8 pjesë, ku përfshin të gjithë zgjedhësit për informimin dhe sensibilizimin për qendrat e votimit, procedurat e

**Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.19.01.2021*

identifikimit, mënyrën e votimit sensibilizimin e grave dhe të rinjve dhe votuesve për herë të parë si dhe personave me aftësi ndryshe. Në fokus është informimi i zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor. Informimi për ndalimin e administratës shtetërore, financimi i partive politike dhe parandalimi i tyre. Në program është parashikuar dhe si fushata e informimit për procedurat e regjistrimit dhe mënyrën e votimit për emigrantët si një risi në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2021. Të gjitha materialet që do të përdoren për sensibilizimin e zgjedhësve do të përkthehen në gjuhën e pakicave kombëtare, në zbatim të detyrimit që burojnë nga ligji për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Programi për edukimin e zgjedhësve të shtetasve për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2021, është një plan që përcakton qëllimet dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për edukimin dhe informimin dhe sensibilizimin e zgjedhësve gjatë periudhës zgjedhore. Ky program përcakton hapat konkretë që do të ndërmerren për realizimin e këtyre objektivave. Ky program është, përmban 8 objektiva kryesore të ndara si më poshtë/// Pjesa e parë është informimi dhe sensibilizimi i zgjedhësve për listën e zgjedhësve në qendrat e votimit. Pjesa e dytë përmban informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi procedurat e identifikimit elektronik në ditën e zgjedhjeve. Pjesa e tretë ka të bëjë me informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi mënyrën e votimit dhe përmbajtjen e fletës së votimit dhe shënimet konkrete që do të bëjnë zgjedhësit mbi këtë fletë. Pjesa e katërt është sensibilizimi i grupeve vulnerabël dhe votuesve për herë të parë. Pjesa e pestë ka të bëjë me sensibilizimin e grupeve të krijuara për herë të parë për të marrë pjesë në këto zgjedhje. Ky program ka në fokus sensibilizimin e zgjedhësve gra për të shmangur fenomenin negativ të votimit familjar. Pjesa e pestë flet për informimin e administratës publike, për ndalimet dhe kriteret ligjore për zgjedhjet. Sensibilizimin e punonjësve të administratës

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.19.01.2021*

shtetërore gjatë periudhës zgjedhore dhe informimi mbi shkeljet ligjore për veprën penale që mund të kryhen në procesin zgjedhor. Në pjesën e shtatë flitet për informimin dhe sensibilizimin e qytetarëve për të denoncuar shkeljet ligjore që lidhen me financimin e partive politike në portalin e vendosur në dispozicion nga KQZ-ja. Në pjesën e tetë flitet për informimin e emigrantëve mbi procedurat e regjistrimit për të votuar si dhe mënyrën e votimit nga vendbanimi i tyre i përhershëm si një risi në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021. Sfida kryesore e këtij programi është realizimi brenda një kohe të shkurtër dhe implementimi i plotë i të gjitha platformave të komunikimit. Me ndryshimin e fundit të Kodit Zgjedhor institucioni i Komisionit Qendror të zgjedhjeve është riformatuar me këto organe drejtuese siç është KAS-i, Komisioni Rregullator dhe Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, të cilat për nga rëndësia dhe angazhimi kërkojnë shtimin e administratës, duke marrë në konsideratë afatet e ngushta kohore, zbatimin e këtij programi është sfidë për përmbushjen dhe funksionimin e Komisionit Qendror të zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni programin e edukimit të zgjedhësve për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit z.Sekretar! Z.Kaziaj ndonjë mendim, opinion në lidhje me programin e edukimit, a keni ndonjë rekomandim?

**Z.A.Kaziaj:** Faleminderit Z.Celibashi! Është një material goxha voluminoz, siç e shpjegoi dhe z.Merkaj Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së, përmban të gjitha ato elementë që tha z.Merkaj, nuk kam ndonjë gjë në veçanti ndonëse sot na erdhi pak e papritur që do merrej sot kjo seancë publike. Gjithsesi është një proces rutinë i bërë nga KQZ-ja dhe në zgjedhjet e shkuara, është mirë që të bëhet sa më shpejt në të mirë të qytetarëve, për shkak dhe të ndryshimeve të reja që kanë ardhur me

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.19.01.2021*

Kodin Zgjedhor të ri dhe me procedurën e re të themi të votimit dhe të identifikimit biometrik. Unë jam dakord, nuk kam ndonjë gjë për të shtuar!

**Z.I.Celibashi:** Mirë, dakord! Faleminderit z.Kaziaj!

**Z.A.Kaziaj:** Faleminderit ju!

**Z.I.Celibashi:** Meqënëse nuk kemi kontribute të tjera në lidhje me këtë çështje, miratoj programin e edukimit sipas aneksit që i është bashkëlidhur këtij projekt akti, i cili dhe i është dërguar të gjithë palëve të interesuara, parti politike dhe organizatave të shoqërisë civile. Ju falenderoj edhe njëherë për pjesëmarrjen z.Kaziaj. Seancën e deklaroj të mbyllur. Faleminderit! Natën e mirë!

**Z.A.Kaziaj:** Faleminderit!

**Vendimi nr.9**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina KOKOSHI*

